

aderuan në UÇK. Në datën **22.09.1998**, herët në mëngjes, forcat serbe filluan granatimin e fshatit Vaganicë/Vaganica. Në fshat mbetën ushtarët e UÇK-së, kurse fshatin e braktisën banorët një ditë më herët, kur kishte vetëm të shtëna sporadike. Rreth orës 8:00, forcat serbe kanë hyrë në fshat. Sadullahu dhe Avniu gjendeshin në pozicionet në pyll, ndërsa më pas kaluan në pyllin e fshatit **Vërbnicë/Vrbnica**. Po atë ditë, më vonë, kur forcat serbe u nisën në drejtim të fshatit Ashlan/Ošljane, Jetullahu u nis për t'i kërkuar të vëllain dhe të birin. Në pyllin *Zmiç/Zmič*, që i takon fshatit Vërbnicë/Vrbnica, ai i gjeti trupat e tyre pa jetë. Në gjoks i kishin vrimat nga plumbat. Të nesërmen, ai i varrosi Sadullahun dhe Avniun në varrezat në Vaganicë/Vaganica. Pas luftime, në qershor të vitit 2000, mbetjet mortore të Sadullahut dhe Avniut janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmove të Luftës në Shipol/Šipolj [Mitrovicë/Kosovska Mitrovica].

**Burimet:** deklarata J.D, FDH-33481; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Bahri (Smajl) Veseli

(25.02.1962, shqiptar nga Braboniqi/Brabonjić, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, axhustator, gjashtë fëmijë)

Në datën 20.09.1998, Bahriu u nis më këmbë për një vizitë te motra Mihane, e cila jetonte në fshatin Vërbnicë/Vrbnica te Mitrovica/Kosovska Mitrovica. Nuk u kthye për disa ditë resht. Familjarët nuk merakoseshin shumë ngase mendonin se ishte duke ndenjur te motra. Atëbotë, mediat kanë bërë të ditur se policia serbe i kishte vrarë dy shqiptarë në fshatin Vaganicë/Vaganica, por askush nga familjarët e Bahriut as që dyshoi se bëhej fjalë edhe për Bahriun. Në datën 25.09.1998, axha i Bahriut, Fazliu, ka ardhur në shtëpi dhe u ka treguar se policia serbe e kishte vrarë Bahriun me **22.09.1998** në fshatin **Vaganicë/Vaganica**, nëpërmes të cilit ai po kalonte në kthim për në shtëpi. Fazliu kishte shkuar që ta merrte trupin e Bahriut. Nuk kishte mundësi ta barte në fshat dhe e varrosi pranë përroskës, në afërsi të vendit të vrasjes. I kishte vërejtur në trupin e

tij dy plagë nga plumbat, në kokë dhe në kraharorin e majtë. Pas luftime, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Bahriut në varrezat e Braboniqit/Brabonjić.

**Burimet:** deklarata Xh.R, FDH-40578; J. Osmani, *Krimet...*, I, 579.

### Driton (Abit) Smakolli

(19.02.1979, shqiptar nga Rashani/Rašane, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica)

### Rifat (Faik) Smakolli

(1.04.1981, shqiptar nga Rashani/Rašane, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, nxënës)

Rifati dhe Dritoni ishin kushërinj. Në muajin shtator të vitit 1998, kur forcat serbe filluan rrethimin e fshatit, Dritoni me familje u shpërngulën në Banjskë/Banjska [Vushtrri/Vučitrn], kurse Rifati me prindër qëndruan në fshat. Në datën 12.10.1998, Dritoni u kthye në **Rashan/Rašane**. Ai qëndroi te prindërit e Rifatit. Në datën **14.10.1998**, në mëngjes, rreth orës 7:00, Rifati dhe Dritoni dolën për ta kthyer bagëtinë nga pylli. Pasi që kaluan disa orë dhe ata nuk u kthyen, familjarët u nisën për t'i kërkuar. Pas dy ditësh kërkimi, trupat e tyre të pajetë i gjetën në pyllin përmbi fshatin Rashan/Rašane më 16.10.1998. Ata kishin shkelur në një minë tokësore dhe kanë mbetur të vdekur në vend. Po atë ditë, Dritoni dhe Rifati u varrosën në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata A.S, FDH-29842; deklarata R.S, FDH-29843; KMDLNI, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 134, FDH-23857.

### Naser (Izet) Haziri

(23.08.1976, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica)

Në datën **22.12.1998**, rreth orës 19:10, Naseri ishte i ulur në kafenenë *Melisa* në **Mitrovicë/Kosovska Mitrovica**. Një burrë i panjohur nga dera e kafenesë ka shtënë në drejtim të Lulzim Ademit, i cili ishte i ulur pranë tavolinës së afërt. Lulzimi ka qenë pjesëtar i sigurimit lokal, që ishte nën kontrollin e pushtetit serb. Naseri u plagos rëndë më këtë rast. Nga plagët e shkaktuara, Naseri ndërroi jetë në spitalin